



**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “KPU Inspect” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nexhat Pula, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.141/22 të datës 13.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2024, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “KPU Inspect” ShPK me seli në Prishtinë, e datës 21.02.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.141/22 të datës 13.01.2023, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.141/22 të datës 13.01.2023, nën pikën I. është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “KPU Inspect” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nexhat Pula, avokat në Prishtinë, nën pikën II. mbetet në fuqi vendimi nr.08-nr.1412/2020 i datës 16.06.2020 i Komunës së Hanit të Elezit. Ndërsa në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ankesa e paditësit KPU Inspect ShPK, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër aktgjykimit KF.nr.141/22 të datës 13.01.2023 të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi KF.nr.141/22 i datës 16.06.2020 si dhe vendimi i të paditurës Komuna e Hanit të Elezit nr. 08-nr.1412/2020 të datës 16.06.2020 të anulohen si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kolegji Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar, pretendimeve ankimore, në pajtim me nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

**Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.08-nr.1412/2020 i datës 16.06.2020 i Komunës së Hanit të Elezit, është refuzuar ankesa e subjektit afarist “KPU Inspect” ShPK, e parashtruar pranë Komunës Hani Elezit përkatësisht komisionit për procedurën e zgjedhjes së kontesteve dhe ankesave, kundër aktvendimit të Drejtorisë të Zhvillimit Ekonomik për caktimin e taksës vjetore komunale.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Komuna Hani Elezit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 18.08.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit nr.08-nr.1412/2020 i datës 16.06.2020 i të paditurës Komuna Hanit të Elezit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata ka konstatuar se e paditura Komuna Hani i Elezit - Komisioni për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vepruar sipas aktgjykimit të lartcekur ka marrë vendimin 08/Nr.1412/2020 të datës 16.06.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e subjekti në procedurë KPU “Inspect” ShPK, dhe ka lënë në fuqi vendimin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për caktimin e taksës vjetore Komunale për ushtrimin e aktiviteteve afariste në territorin e Komunës Hani i Elezit me 08-Nr.3727/109/2018, të datës 08.05.2018. Me arsyetim se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili është bazë për funksionalizimin e pushtetit lokal, përkatësisht neni 58 pika d) e obligon kryetarin e Komunës që të zbaton të gjitha aktet të cilat miratohen nga Kuvendi Komunal si organ legjislativ në nivel lokal, ku në këtë rast duke angazhuar Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, e njëjta përmes vendimit 08-Nr.3727/109/2018 të datës 08.05.2018 e ka ngarkuar subjekti afarist me taksë vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Tutje ka theksuar gjykata në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur ka marrë parasysh Ligjin Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronë, i cili nuk ka të bëjë Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale, sepse në pronë është një taksë që është kompetencë gjysmë e deleguar nga ana e Ministrisë dhe se fare nuk ka të bëjë me aktvendimin 08Nr.3727/109/2018 të datës 08.05.2018. Pra, gjykata në aktgjykimin A.nr.667/19 të datës 25.02.2020 në asnjë moment nuk ka kërkuar dhe nuk e ka cekur Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale si akt komunal me të cilën bazë është ngarkuar subjekti afarist KPU “Inspect” ShPK. Nga kjo gjendje e faktike, Gjykata ka pranuar si të ligjshëm dhe të drejtë arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet e paditësit se e paditura nuk ka vepruar fare në bazë të kërkesës së gjykatës e cila me aktgjykimin A.nr.667/19 të datës 25.02.2020, ka kërkuar nga i padituri që në ri procedurë të veprojnë sipas pikëpamjeve juridike të gjykatës, si dhe vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, sepse sipas vlerësimit të gjykatës vendimi i kontestuar i të paditurës është i qartë dhe i kuptueshëm. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se është i pa bazuar i paditësit se detyrimi që i është caktuar paditësit nga i padituri për të paguar shumën prej 4,000.00 €, siç ceket në emër të ngarkesës vjetore nga ushtrimi i veprimtarisë së biznesit, e duke u thirrur në Rregulloren për pagesën e taksave, tarifave dhe ngarkesave administrative 02.nr.1265, ashtu si edhe në aktvendimin mbi ngarkesën vjetore nga ushtrimi i veprimtarisë së biznesit 08.Nr.3727/109-2018, e që janë plotësisht të baza, pasi që aktet e cekura më lartë të paditurit janë në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kjo pasi që në nenin 8 i cili përcakton kategoritë e të hyrave vetanake të Komunës dhe as me dispozitat tjera të këtij ligji,

kjo për faktin se e paditura ka vepruar drejtë kur me rastin e marrjes së vendimit 08.Nr.3727/109-2018 të datës 08.05.2018, është bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Administrative e cila është taksë e veçantë, ngase siç u theksua më lartë Kuvendi i Komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës”. Gjykata ka vlerësuar se vendimi me 08-Nr.1412/2020 i datës 16.06.2020 i Komunës së Hanit të Elezit, me të cilin është refuzuar ankesa e këtu paditësit e ushtruar kundër vendimit të Komunës së Hanit të Elezit - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik 08.Nr.3727/109-2018 të datës 08.05.2018, sipas të cilit vendim paditësit i është caktuar ngarkesa vjetore për ushtrimin veprimtarisë në territorin e Komunës Hani i Elezit, në total shuma prej 4,000.00 € (borxhi paraprak), është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar mbështetur nga dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e paditësit se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së parë nuk bazohet në fakte dhe prova të vlefshme, pasi që paditësi me fakte dhe prova ka argumentuar se vendimi kontestues i të paditurit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Komunal. Dhoma e Shkallës së Dytë të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Po ashtu Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura me rastin e marrjes së vendimit është bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Administrative e cila është taksë e veçantë e miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari e që i miratojnë aktet me qëllim që të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre, aktet e tilla janë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor në Republikën e Kosovës, andaj paditësi në këtë rast është dashur të i përmbahet rregullores së nxjerrë nga Kuvendi Komunal dhe të kryej pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë së tij afariste në territorin në të cilin vepron dhe punon.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se vendimi kontestues i të paditurit me 08 nr.1412/2020 i datës 16.06.2020 me të cilin ngarkohet paditësi me taksë për ushtrimin e veprimtarisë afariste, por nuk ceket shuma e këtij obligimi dhe nuk është cek periudha kohore e ngarkesës, elemente këto qenësore që duhet t'i ketë një vendim i këtij karakteri, andaj vendimin kontestues e bënë të mangët dhe jo të plotë dhe rrjedhimisht edhe të pa bazuar dhe të pa vlefshëm. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara. Kjo për faktin se pas shqyrtimit dhe analizimit të dispozitës ligjore dhe rregulloreve komunale, kolegji vlerëson se vendimi është konform ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga Komuna e Hanit të Elezit me anë të cilave përcaktohen taksat vjetore për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste të cilat e ushtrojnë veprimtarinë afariste

në territorin e Komunës dhe duhet të paguajnë taksën komunale për shërbime publike. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë duke analizuar bazën ligjore përkatësisht nenin 8 dhe 10 të Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale si dhe Ligjin 03/L049 për Financat e Pushtetit Lokal, me të drejtë ka konstatuar se vendimi i të paditurës është i qartë dhe përmban elementet e detyrueshme të aktit të shkruar të paraparë me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, sikurse akti administrativ i të paditurës 08.Nr.3727/109-2018 të datës 08.05.2018 me të cilin është konstatuar gjendja faktike lidhur me caktimit të taksave ndaj paditësit, ashtu edhe vendimi i kontestuar me padi përmbajnë pjesën hyrëse dhe pjesën urdhëruese në vështrim të nenit 47 par.1 pika 1.1, 1.2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.469/23, me datë 08.05.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**